

Mundësi punësimi: Koordinator/e pranë Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare Tiranë,

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare njofton të gjithë personat e interesuar se shpall pozicionin vakant për Koordinator/e me kohë të plotë.

Përshkrimi i Pozicionit të Punës:

Koordinatori/ja do të jetë përgjegjës/e për:

-organizimin e aktiviteteve të projektit dhe përmbushjen e rezultateve të tij sipas parashikimit në projektpropozim;

-rekrutimin e stafit të projektit sipas rregullores dhe procedurave të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, kërkesave të donatorit, kodit të punës, dhe rekomandimeve të auditit si dhe përgatitja e kontratave;

-bashkëpunimin me skuadrën e projektit;

-Kryerjen e procedurave të prokurimit për shpenzime të parashikuara në projekt në bashkëpunim me ekipin e qendrës;

-Mbajtjen sistematike dhe të rregullt të dokumenteve të projektit;

-Detyra të vecanta specifike janë të përcaktuara në manualin e procedurave dhe politikave të qendrës;

-Detyra të tjera mund t'i shtohen gjatë punës sipas nevojave të qendrës;

Pozicioni i punës kërkon një angazhim me kohë të plotë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Te këtë mbaruar studimet Bachelor dhe Master në shkenca shoqërore, drejtësi, ose në degën Financë; Kur ka përfunduar vetëm studimet Bachelor, kjo duhet shoqëruar me një përvojë të pasur në menaxhimin e projekteve.

- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze ;

- Të njoh shumë mirë paketën microsoft office, vecanerisht Excelin dhe Power point;

- Të jetë i/e motivuar në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të këtij pozicioni.
- Të jetë sistematik i programuar dhe të ketë njohuri në ruajtjen e dokumentacionit të projekteve.
- Te jetë i/e gatshëm të punojë dhe me orare të zgjatura kur të ketë nevojë qendra.

Preferohet:

- Të ketë eksperiencë pune në shkrimin, koordinimin dhe menaxhimin e projekteve të organizatave të shoqërisë civile, e cila përbën një asset të rëndësishëm;

Në përputhje me Nenin 142 të Kodit të Punës, të ndryshuar, “Koha e provës” konsiderohet si kohë prove 3 muajt e parë të punës.

Me qëllim aplikimin në këtë pozicion, kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin si vijon:

1. CV e kandidatit/es;

2. Kopje te Diplomës, të shoqëruar me kopje të listës së notave të studimeve Bachelor dhe/ose Master, ose ekuivalente me to;

3. Dokument që provon njohuritë e gjuhës angleze;

4. Çdo dokumentacion të nevojshëm që tregon kualifikimet e kandidatit/es dhe përvojat e mëparshme;

5. Dëshmi penaliteti;

6. Preferohet të dorëzohet edhe një letër reference nga punëdhënës të mëparshëm

Afati i fundit i aplikimeve do të jetë data 27 Gusht 2021, ora 16.00. Dokumentacioni mund të dërgohet i skanuar në adresën e emailit avokatore2@yahoo.com ose, të depozitohet pranë zyrave të Qendrës për Nisma Ligjore me adresë Rruga “Vaso Pasha” Pll.12, Shk.1, Ap. 1 Tiranë.

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare rezervon të drejtën që në cdo kohë ta shtyjë ose ta anullojë këtë thirrje nëse aplikantët/et nuk përmbushin cilësinë dhe kriteret e kërkuara.